

UNIVERSITETI I TIRANËS  
FAKULTETI I GJUHËVE TË HUAJA  
DEPARTAMENTI I GJUHËVE SLLAVE DHE BALLKANIKE

# PROJEKT I KONFERENCËS SHKENCORE NDËRKOMBËTARE

“TERMINOLOGJIA NË FUSHAT HUMANITARE  
DHE PASQYRIMI I SAJ NË FJALORË  
(TERMINOLOGJIKË, SHPJEGUES DHE  
DYGJUHËSORË)”

Koordinator e projektit:  
Prof.Asoc.Dr. Eda SHEHU  
[eda.shehu@unitir.edu.al](mailto:eda.shehu@unitir.edu.al)

TIRANË, 2022

## PËRMBLEDHJA E PROJEKTIT

**Terminologjia (si një sistem termash) përbën një sektor të mëvetësuar të çdo gjuhe kombëtare, që lidhet ngushtë me veprimtaritë e fushave të ndryshme të dijes. Termat e çdo dege të shkencës, teknologjisë, prodhimit, formojnë sistemet e tyre, të përcaktuara, para së gjithash, nga lidhjet konceptuale të njohurive profesionale në një përpjekje për të shprehur këto lidhje me mjete gjuhësore. Të gjitha këto terma janë pasqyruar në fjalorët e gjuhëve të huaja (*terminologjikë, shpjegues dhe dygjuhësorë*) dhe shërbejnë për studime dhe në përkthime të teksteve të fushave të ndryshme të shkencës dhe teknikës. Specialistët në bashkëpunim me gjuhëtarët, terminologët, kanë hartuar fjalorët terminologjikë të këtyre fushave duke bërë sistemimin, njësimin dhe shqipërimin e termave përkatës, të cilët përdoren në praktikën ligjërimore, në mësimdhënie, në përkthim etj. Në këtë konferencë vëmendje do t'i kushtohet hulumtimit të terminologjisë së fushave humanitare.**

**Kjo konferencë shkencore ndërkombëtare do të bazohet mbi hulumtime, këndvështrime, të cilat japin lëndë të mjaftueshme për analiza e përgjithësime, që mendojmë se do t'u jenë të dobishme për studiuesit që lidhen me këto nëntema, si:**

- Terminologjia e fushave humanitare në gjuhën shqipe në marrëdhënie me fushat teknike dhe natyrore;*
- Marrëdhëniet e leksikut të përgjithshëm me leksikun terminologjik në fusha të ndryshme të dijes;*
- Marrëdhëniet e termave të huaj në gjuhën shqipe me termat e shqipëruar;*
- Shqipërimet në fjalorët terminologjikë;*
- Vëzhgime gjuhësore rreth llojeve të fjalorëve dygjuhësh;*
- Raporti i përdorimit të termave të huaj në fjalorët terminologjik gjuhë e huaj – shqip.*
- Fjalorët terminologjikë dhe përkthimi;*

- *Probleme të dysorëve në fjalorët terminologjikë;*
- *Probleme të homonimisë dhe polisemisë në fjalorët terminologjikë;*
- *Probleme të sinonimisë në fjalorët dygjuhësh;*
- *Reflekse të teorisë së terminologjisë në fjalorë;*
- *Studime teorike të terminologjisë në praktikën e hartimit të fjalorëve terminologjikë;*
- *Hartimi i fjalorëve të termave të fushave të ndryshme të dijes;*
- *Arritje dhe probleme të hartimit të fjalorëve dygjuhësh;*
- *Probleme dhe zgjidhje në hartimin e fjalorit terminologjik gjuhë e huaj – shqip.*
- *Pasqyrimi i termave në fjalorët shpjegues (1980-2006);*
- *Përfaqësimi i termave njëfjalësh dhe togfjalësh në fjalorët terminologjikë;*
- *Pasqyrimi i termave në fjalorët dygjuhësh si gjuhë të huaja për shqipen;*
- *Pasqyrimi i termave në fjalorë dhe përdorimi i tyre në praktikën ligjërimore;*
- *Terminologjia në procesin e mësimdhënies;*

# OBJEKTIVAT

- Objekti i kësaj konference nuk është vetëm për të mundësuar prezantimin e rezultateve të reja të hulumtimit, ekspozimi i praktikave, përvojave dhe i modeleve të edukimit ndërkulturor në Shqipëri, Bullgari, Kosovë etj., por edhe për të shkëmbyer mendime, këndvështrime e ide të reja kërkimoro-shkencore mes kapaciteteve të njohura në fushën e leksikut terminologjik në marrëdhënie me leksikun e përgjithshëm, veçanërisht në hartimin e fjalorëve (*terminologjikë, shpjegues, dygjuhësh*).

## REZULTATET E PRITSHME

- **Kjo konferencë do të marrë një rëndësi të vlerës së shtuar edhe për faktin se, partneritetit shkencor - universitar, i lidhjeve bashkëpunuese të vendosura më parë, me rastin e konferencave shkencore të shkuara, u shtohen për bashkëpunim edhe aktorë të rinj të botës akademike-universitare, duke e forcuar kështu kapacitetin e një sinergjie akademike, intelektuale dhe shkencore në rrafsh Ballkanik si dhe, brenda rrafshit ndërshqiptar.**
- **Kjo konferencë shkencore do të shënojë një ngjarje të veçantë jo vetëm për dimensionin shkencor që karakterizon një konferencë ndërkombëtare, por është dhe një kontribut të vlefshëm në kuadër të përsosjes së terminologjisë së fushave humanitare, ngritjes cilësore të saj dhe hartimit të fjalorëve në gjuhë të huaja, si dhe në kërkimin shkencor, të cilat janë çështje shumë të rëndësishme për shoqërinë tonë.**

## **ANALIZA E GRUPEVE TË SUNUARA DHE E PALËVE TË INTERESIT NGA PROJEKTI**

**Njohja e leksikut të fushave të caktuara semantike dhe e përpjekjeve të gjuhëtarëve apo specialistëve për t'a pasuruar atë duke u mbështetur kryesisht mbi brumin e shqipes, do të shërbejë për hartimin e fjalorëve të ardhshëm të fushave humanitare, të gjuhës shqipe dhe gjuhëve të huaja si dhe për mënjanimin e fjalëve të panevojshme nga përdorimi. Studimi i ndikimit të teorisë së terminologjisë në hartimin e fjalorëve terminologjikë të derisotëm ka nevojë për t'u thelluar më tej në dritën e teorive dhe konceptimeve të reja shkencore të kësaj fushe për t'i zbatuar ato në fjalorët e së ardhmes, të cilët duhet të mbështeten mbi metodat e teknologjisë së sotme, si mjeti kryesor i terminologjisë moderne, drejt të cilave duhet të synojë edhe terminologjia dhe terminografia shqiptare.**

# AKTIVITETET E PROJEKTIT

**Aktiviteti nr.1 - Takim pune me bashkëpunëtorët e projektit. Do të diskutohen temat e referateve dhe kumtesave të paraqitura nga pjesëmarrësit që do të shprehin dëshirën për të qënë pjesë e kësaj konference. Po kështu do të përzgjidhen temat që përkojnë me temën bosht të konferencës.**

**Aktiviteti nr.2 - Paraqitja e programit të konferencës nga anëtarët e grupit të punës dhe afishimi dhe shpërndarja e tij online dhe me email pjesëmarrësve të konferencës. (Përcaktimi i kohës së mbajtjes së referatit ose kumtesës (15 min) dhe zhvillimi i konferencës në tre seanca: dy paradite dhe një mbasdite). Një pjesë e buxhetit të përcaktuar do të gjykohet mbi procese të tjera: pritja, akomodimi në hotel, ushqimi etj.**

**Aktiviteti nr.3 - Organizimi i konferencës në mjediset e Fakultetit të Gjuhëve të Huaja, shtrimi i koktejlit për të ftuarit vendas dhe të huaj, si dhe coffe breake ndërmjet seancave. (Parashikohet një ekspozitë me botime, fjalorë të llojeve të ndryshme etj.)**

**Aktiviteti nr.4 - Mund të organizohen veprimtari të ndryshme me pjesëmarrësit e konferencës, si vizita në vende kulturoro – historike;**

**Aktiviteti nr.5 - Organizimi i punës për hartimin dhe botimin e akteve të konferencës.**



# REZULTATET E PRITSHME

**Njohja dhe zotërimi i terminologjisë në kohën tonë është kusht i domosdoshëm për çdo veprimtari. Në këtë tubim shkencore mbi terminologjinë dhe pasqyrimin e saj në fjalorët e fushave humanitare do të shtrohen diskutime të ndyshme mbi çështjet e trajtuara në kumtesat e kësaj konference, krahas çështjeve të tjera që mund të propozohen. nga specialistë brenda dhe jashtë vendit. Në fund të referimeve dhe diskutimeve do të arrihen sugjerime të vlefshme për gjithë pjesëmarrësit dhe të interesuarit..**

**Prandaj terminologjia e fushave humanitare dhe përdorimi i saj në fjalorë në gjuhë të huaj ka shumë rëndësi për kohën, ajo duhet të jetë e përpunuar dhe e standardizuar. Leksiku terminologjik, d.m.th. fjalët terma dhe fjalët me kuptime terminologjike, po marrin një peshë gjithnjë e më të madhe në fjalorin e çdo gjuhe, sidomos në kohën e sotme në procesin e hartimit të Fjalorit të Madh të gjuhës shqipe. Edhe për gjuhën shqipe një terminologji e standardizuar dhe e njësuar me kritere shkencore është parakusht për një fjalor shpjegues modern, të termave themelore të gjuhës së shkencës e teknikës dhe të fushave humanitare, që të përfshijë pasurinë leksikore themelore të mbarë shqipes. Puna jonë krahas standardizimit të terminologjisë, do të jetë një nxitje për specialistët dhe gjuhëtarët (terminologët), studiuesit, për hartimin e fjalorëve të rinj me një strukturë terminologjike të krahasueshme me fjalorët e gjuhëve të tjera, sidomos të gjuhëve që shërbejnë si model standardizimi.**

## **PRODUKTI I PROJEKTIT**

**Rezultatet e këtij tubimi shkencor do të pasqyrohen në botimin e akteve të kësaj konference, si dhe në botime të tjera, nga të cilat do të përfitojnë të interesuarit që merren me studimet në këtë fushë.**

**UNIVERSITETI I TIRANËS**  
**FAKULTETI I GJUHËVE TË HUAJA**  
**DEPARTAMENTI I GJUHËVE SLLAVE DHE BALLKANIKE**

***JU FALEMINDERIT PËR VËMENDJEN!***

Tiranë, 2022

